

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Thermogroup-AL." SHPK**

Sot më datë 01.02.2023, ne baze te ligjit tregtar themelohet shoqëria si me poshte:

Ortaku:

EDVIN SELA , shtetas Shqiptar, lindur ne Durres dhe banues në Durres , lindur më 17.03.1980, gjendja civile "martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, nr. personal I00317218B

Ne baze te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008"Per tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe ne ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 për Q.K.R, kërkoi redaktimin e Aktit te Themelimit dhe Statutit te Shoqërisë me përgjegjësi te kufizuara si me poshtë vijon:

**NENI 1
EMERTIMI I SHOQERISE**

Emri i shoqërisë është "**Thermogroup-AL.**" (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

**NENI 2
SELIA LIGJORE**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adrese: Durres, Lagjja nr. 14, Shkozet, , Objekt me nr. Pasurie 7/259, Zona Kadastrale 8516
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund te vendose mbi transferimin e selisë se Shoqërisë ne një adrese tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund te themeloje ose mbylle dege dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërisë.

**NENI 3
KOHEZGJATJA**

- 3.1 Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe te pacaktuar

**NENI 4
OBJEKTI I SHOQERISE**

- 4.1 Shoqëria ka për objekt te saj kryerjen e te gjitha aktiviteteve qe një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar mund te ushtroje ne baze te legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë, duke përfshire por pa u kufizuar ne:
Tregti te artikujve te ndryshem industrial. Import eksport. Sherbime, riparime, asistence, shitje termo sanitare. Showroom produkte Ariston. Shitje me shumice e pakice, etj

**NENI 5
KAPITALI I SHOQERISE**

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 100.000 leke
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë perbehet nga 1 kuote, si me poshte vijon:

EDVIN SELA, shtetas Shqiptar, lindur ne Durres dhe banues në Durres , lindur më 17.03.1980, gjendja civile "martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, nr. personal 100317218B me 1 kuote qe perben 100% te kapitalit me vleren 100.000 leke

- 5.3 Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga Ortaket themelues.
- 5.2 Asnjë nga ortaket nuk mund te transferoje kuoten përkatëse te pjesëmarrjes ne Shoqëri pa miratimin paraprak me shkrim te ortakeve te tjerë. Ne rast se një nga ortaket dëshiron te kaloje/transferoje plotësisht apo pjesërisht kuotën e tij ne Shoqëri, duhet t'ia ofroje ketë kuote për blerje ortakeve te Shoqërisë. Brenda 30 (tridhjetë) diteve nga ofrimi i kuotës për blerje, ortaket do te kenë te drejtën te blejnë kuotën e ofruar ne shitje sipas çmimit dhe mënyrave te pagesës për te cilat kane rene dakord me ortakun shitës.
- 5.3 Ne rast zmadhimi apo zvogëlimi te kapitalit themeltar te Shoqërisë, ortaket do te kenë te drejtën e nënshkrimit te zmadhimit apo zvogëlimit te kapitalit ne përpjesëtim te drejte me pjesëmarrjen qe zotëron secili ne kapitalin e Shoqërisë.

NENI 6

KALIMI I KUOTES ME TRASHËGIMI (MORTIS CAUSA) OSE PER SHKAK TE FALIMENTIMIT TE ORTAKUT

- 6.1 Ne rast vdekje apo falimentimi te njërit prej ortakeve, kalimi i kuotës dhe i te drejtave përkatëse ne favor te trashëgimtareve apo personave qe fitojnë këto te drejta duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila duhet te shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vdekjes apo i falimentimit te ortakut. Ne rast refuzimi te pëlqimit apo nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është shprehur brenda afatit te sipërpërmendur, Shoqëria do t'ju paguaje trashëgimtareve apo personave qe fitojnë këto te drejta vlerën e kuotës qe do te përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme, duke pasur parasysh gjendjen pasurore te Shoqërisë dhe vlerën e tregut te kuotës.
- 6.2 Personi qe fiton te drejtën mbi kuotën e pjesëmarrjes për shkak te vdekjes apo falimentimit te një ortaku mund te zgjedhe te behet zotërues i kuotës ose te kërkoje regjistrimin e kuotës ne emër te një personi tjetër te zgjedhur prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh te behet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë ne lidhje me këtë vendim.
- 6.3 Personi qe fiton te drejtat mbi një kuote për shkak te vdekjes apo falimentimit te një ortaku do te këtë te drejtat qe gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar te drejtën e pjesëmarrjes ose te votës ne çdo mbledhje te Asamblesë se Përgjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit si zotërues i kuotes.

NENI 7
ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.10 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 7.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejte me kuotat që zotërojnë në Shoqëri.
- 7.3 Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panëshkruar prej tyre mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë serish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejte me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

NENI 8
ZVOGELIMI I KAPITALIT

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.10 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.
- 8.2 Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejte me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 9
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vend ose mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akti Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.
- 9.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.
- 9.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër, me prokurë me shkrim .
- 9.4 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call) audio ose video, në përputhje me ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverballi përkatës.

- 9.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratoret ose nga ortakët në bazë të nenit 84 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare". Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, kur ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord të vendosin në lidhje me rendin e ditës.
- 9.6 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratoret. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje ndër personat e pranishëm.
- 9.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 9.8 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 9.9 Asambleja e Përgjithshme, përveçse për sa parashikon neni 9.10 i këtij Akti Themelimi dhe Statuti, për vendime që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zoterojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, sipas nenit 86 pika I, të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare".
- 9.10 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të të paktën 51 % të ortakëve pjesëmarrës (shumica e kualifikuar) në bazë të nenit 87 pika I, të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare", për ndryshimin e këtij Akti Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

NENI 10 ADMINISTRIMI I SHOQËRISE

- 10.1 Shoqëria administrohet nga Administratori/et i cili/te cilët për një periudhë prej maksimumi 5 (pese) vjetësh. Administratori/et mund të rizgjidhen dhe shkarkohen në çdo kohë nga Asambleja e përgjithshme. Aktualisht Asambleja e Përgjithshme administrohet nga 1 administrator:

EDVIN SELA, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, lindur më 17.03.1980, gjendja civile "martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, nr. personal I00317218B

- 10.2 Administratori/t zotëron kompetencë të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektivit të Shoqërisë, përveç veprimeve, përmbushja e të cilëve i rezervohet Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të autorizojë persona të tretë, për të përmbushur veprime të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast, administratori do të jetë përgjegjës për veprimet e të tretëve të autorizuar.
- 10.3 Asambleja e Përgjithshme vendos shpërblimin e administratorëve të shoqërisë.

- 10.4 Administratoret nuk do të mund të marrin hua nga Shoqëria ose të lëshojnë garanci, dorëzani, në emër dhe për llogari të Shoqërisë, për hua dhe financime të dhëna nga të tretet.
- 10.5 Administratoret do të veprojnë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti të interesit, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 11 VITI FINANCIAR

- 11.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 12 KONTROLI FINANCIAR

- 12.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Eksperte Kontabël të Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Eksperte Kontabël të Autorizuar në atë rast kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 13 BILANCI VJETOR

- 13.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrativ mbi ecurinë e veprimtarisë sociale dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 13.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 14 DIVIDENDET

- 14.1 Në përputhje me dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividendëve në bazë të rezultatit financiar të shoqërisë.

NENI 15 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 15.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, administratorëve, likuiduesit, do të nënshtrohen juridiksionit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 16 GJUHA

- 16.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) ekzemplare në gjuhën shqipe.

NENI 17

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

17.1 Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Akt Themelimi dhe Statut dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në këtë Akt Themelimi dhe Statut, do të zbatohen parashikimet e ligjit nr. 9901 i datës 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare".

ORTAKU I SHOQERISE

EDVIN SELA

